

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Menaxheri i Operimit dhe Mirëmbajtjes së Autostradës

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Menaxheri i Operimit dhe Mirëmbajtjes së Autostradës është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe funksionimin e suksesshëm të rrugës. Mbikëqyr dhe koordinon të gjitha aktivitetet që lidhen me mbledhjen e tarifave dhe menaxhimin e trafikut.

❖ DETYRAT KRYESORE

Përgjegjësitë specifike përfshijnë:

- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive operacionale për të optimizuar rrjedhën e trafikut dhe mbledhjen e të ardhurave.
- Analizimi i të dhënave ditore të trafikut dhe transaksioneve të tarifave për të identifikuar tendencat dhe nevojat e mundshme për përmirësim.
- Drejtimin dhe kontrollin e mbikëqyrësve të turneve, operatorëve të kabinave, ekipeve të mirëmbajtjes dhe stafit të shërbimit ndaj klientit.
- Bashkëpunimi me Departamentin e Finances për të monitoruar dhe kontrolluar transaksionet financiare
- Sigurimi i pajtueshmërisë me kërkesat rregullatore, zbatimi i protokolleve të sigurisë dhe trajtimi i çështjeve të lidhura me sigurinë.
- Kryerja e vlerësimeve të rregullta të performances se stafit
- Krijimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me aktorët kryesorë, duke përfshirë agjencitë qeveritare dhe publikun.
- Mbikëqyrja e planifikimit dhe ekzekutimit të fushatave të marketingut dhe ndërgjegjësimit publik.

Raporton tek: CEO

❖ KRITERET KRYESORE

- Të ketë përfunduar Fakultetin e Ekonomisë ne degen Finance ose Administrim Biznesi, ose Fakultetin e Inxhinierise se Ndërtimit.
- Aftësi në përdorimin e sistemeve të mbledhjes së tarifave dhe teknologjive përkatëse ;
- Aftësi për të kuptuar dhe punuar me të dhënat financiare dhe operacionale;

- Njohuri ne programe te ndryshme financiare, Ms Office;
- Njohuri te gjuhes angleze (shume mire);
- Mbi 6 vite eksperiencë pune, ne pozicione te ngjashme menaxheriale
- Preferohet eksperiencë specifike në sistemet e mbledhjes së tarifave, menaxhimin e objekteve të tarifave dhe menaxhimin e trafikut.

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare ëëë.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 10 Maj 2024, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale